



Republika e Kosovës



Komuna e Istogut

**KONTRATË PUBLIKE KORNIZË PËR SHERBIME  
(ME NJË OPERATOR)**

**KOMUNA E ISTOGUT**, Njesia e Prokurimit te cilën e përfaqqëson Menaxheri-ja e Prokurimit z-nja Zizë Bujupaj, Adresa Rruga “Fadil Ferati” nr 121. Me nr. tel 038 200 43 858, ne cilësinë e porositësit te sherbimeve të Autoritetit Kontraktues në njëren anë;

dhe

NPSH “MESHARI” nga Istogu, Komuna e Istogut, me NRB 80043228 të cilën e përfaqqëson, z. Zeqir Mehmetaj, ne vazhdim “kryersi i shërbimeve”, në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për shërbimet si më poshtë:

**PUBLIKIMI I NJOFTIMEVE NE RADIO LOKALE PËR NEVOJAT E KOMUNËS**

Nr. I prokurimit	633-18 - 2681 -2-2-1/ FA/028
Nr. I brendshëm	633 / 018 / 019 / 221

**Neni 1      Lënda**

1.1 Lënda e kontrate publike kornizë është të krijoj kushtet, duke përfshirë çmimet për njësi dhe rregullat e implementimit për shërbimet si në vijim: Publikimi I NJOFTIMEVE në radio për nrvoja te Komunës siq është përcaktuar në dosjen e tenderit.

## **PUBLIKIMI I NJOFTIMEVE NE RADIO LOKALE PËR NEVOJAT E KOMUNËS**

**Specifikimi I detyrueshem teknik dhe fomulari I çmimeve të datës 30.07.2018 është pjesë përberese e kontratës dhe e njejtë është bazë për pagesën e kontraktorit.**

**Autoriteti Kontraktues bënë kryerjen e shërbimeve vetëm në emrin të vetë Autoritetit**

1.2 Kontrata publike kornizë do të implementohet me "vendosjen e porosive" apo thirrje. P.sh. Kurdo që Autoriteti Kontraktues apo ndonjë Autoritet tjeter Kontraktues i përfshirë në këtë kontratë, tenton të kryej në bazu të kësaj kontrate publike kornizë, duhet që të dërgojë "porosinë" tek furnizuesi, duke specifikuar listën me artikuj përfurnizim me sasitë e tyre përkatëse.

1.3 Sositë e vlerësuara, të përcaktuara në Pjesën C, Lista e Çmimit, janë vetem sasi indikative Autoriteti(ët) Kontraktues i përmendur në Nenin 1.1 është (janë) të detyruar të përdorin këtë marrëveshje kornizë sa herë që të kryejnë sherbime të përmendura në 1.1.

1.4 Kontrata hynë në fuqi më NËNSHKRIMIN E SAJË PËRKATËSISHT ME DATË 18.09.2018 DHE DO TE PERFUNDODJË ME SË LARTI DERI ME 18.09.2019 PASI KONTRAKTORI TE SJELLË DESHMINË MBI SIGURINË PER EKZEKUTIMIN E KONTRATËS ME VLEFSHMËRI PREJ 13 MUAJVE, NGA DATA E NËNSHKRIMIT TË KONTRATËS.

### **Neni 2 Koha e perfundimit**

2.1 Afati kohor për dorëzim dhe kryerjen e te gjitha SHERBIMEVE do të jetë: 18.09.2019 si afat i skadimit te kontratës.

2.2 Vendi i kryerjës së shërbimeve do të janë emetimi I publikimeve per KOMUNËN E ISTOGUT – varesisht nga kerkersa e personave te autorizuar.

2.3. Obligimet e kontraktorit (kryersit te shërbimit) janë te gjitha sherbimet të përcaktuara ne Nenin 2.1 e dosjes së tenderit dhe kushteve te pergjithshme dhe te veqanta te kontratës.

2.4 Inkotermi I zbatueshëm do të jetë DDP1 (Dërgesat e Detyrës të Pagues).

### **Neni 3 Çmimi**

3.1 Çmimet njësi të shërbimeve janë paraqitur në Ofertën Financiare, Lista e Çmimit e paraqitur nga kryersi I shërbimeve I dates: 08.05.2018

Vlera totale indikative e kontratës është: 9.950,00 Euro.

Dhe me shkronja: /Nëntëmijëenëntëçindëpesëdhjetëeuro/

4.2 Çmimi i përmendor për NJESI në Nenin 4.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh kontraktorit sipas kontratës publike kornizë.

4.3. Çmimet njesi do te jene fikse. Në lidhje me çdo pjesë tjeter nga ato qe jane ne nomenclature, ne lidhje e çdo pjese tjeter reserve e cila NUK është listuar në përshkrimin e çmimeve: ne rast se pjeset origjinale janë ne dispozicion, çmimi per pjese do te jetë çmimi I percaktuar ne listen e çmimit te prodhuesit ne Kohen e leshimit te urdherblerjes. Në rast se pjeset dhe materialet e automjeteve nga prodhuesi (Genuine Manufacture'sparts) nuk jan ne dispozicion (psh per automjetet e vjetra), ofruesi I sherbimeve duhet te informoje menaxherin e kontratës I cili mund te bie dakord per instalimin e pjesave standard ekujvalente si" OEM (OriginalEquipmentManufactures) I cili duhet te shqyrtohet dhe miratohet nga ekspert teknik te Autoritetit Kontraktues.

4.4 Pagesat do të bëhen në përputhje me Kushtet e Përgjithshme dhe/ose të Veçanta të Kontratës.

#### Neni 5 Rendi i përparësisë së dokumenteve të kontratës

5.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Kontrata Publike Kornizë;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Furnizuesit, duke përfshirë Specifikimet Teknike;
- (e) Oferta financiare (Lista e Çmimeve);
- (f) Urdhër blerja;

#### *Plani per menaxhimin e kontrates*

5.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

#### Neni 6 Komunikimet

6.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Furnizuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

6.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tijë.



6.3 Kudo qe në kontratë parashikohet dhënia e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përvëç nëse specifikohet ndryshe në njoftimin e tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njoftoj", "vërtetoj", "miratoj" ose "vendosë" do të shenohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë

miratim, pajtim, certifikatë ose vendimi i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsyé

6.4 Kjo kontratë është përgatitur në gjuhet [Angleze] [Shqipe] [Serbe] 2. në tri origjinalë, dy origjinalë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Furnizuesin.

Për Kontraktuesin:

Për Autoritetin Kontraktues:

Emri:	Zeqir Mehmetaj		Zizë Bujupaj
Pozita:	D re j t o r	Pozita:	Zyrtar Përgjegjes i Prokurimit
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	18.03.2018	Data:	2018
Vula:		Vula:	